

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 1-rë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele,**  
**mbajtur më 9.1.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr.Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska, mr.Emilia Janevska, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunovic, mr.Arben Saiti, mr.Gorjan Sheqerinov, Maja Damevska,dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 1-rë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 46-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.12.2022.
2. Propozim për ndërprerjen e procedurës së ngritur për heqjen e lejes ndaj TV Iris nga Shtipi.
3. Propozim për fillimin e konsultimit publik për ndryshimin dhe plotësimin e "Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe tkuadrovice për dhënien e lejes për transmetim në televizion dhe radio" pas Kërkesës së dorëzuar nga SHGM.
4. Propozim - Vendim për refuzimin e Kërkesës për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit dixhital tokësor, paraqitur nga ana e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJ Shtip.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna Llabunishtës SHPKNJ për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur .
6. Propozim për shqiptimin e vërejtjes publike ndaj Shoqërisë Tregtare për veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna Llabunishtës SHPKNJ për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.

7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Njesisë Organizative Jofitimprurës Radiodifuzive RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 - Universiteti “Shn. Kirili dhe Metodi”, Shkup për shkelje të nenit 97, paragrafi (2) të LSHMAAV.
8. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Njesisë Organizative Jofitimprurës Radiodifuzive RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9 - Universiteti “Shn. Kirili dhe Metodi”, Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Mediat .
9. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI I USKANËS MEDIA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
10. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO MARIJA-BLAGOVEST Strumicë për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV .
11. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës RADIO UNIVERSITARE UGD FM - Universiteti Goce Dellçev Shtip për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) të LSHMAAV .
12. Propozim për sigurimin shtesë të mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës për furnizim publik - mallra: Sistemi për menaxhim automatik me dokumente.
13. Propozim – vendim për miratimin e mjeteve financiare për parapagim në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” për vitin 2023.
14. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 46-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 21.12.2022, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për ndalimin e procedurës së iniciuar për marrjen e lejes të TV Iris nga Shtipi. Ai ka shpjeguar se për këtë transmetues nuk ka informacion nëse i plotëson kushtet për numrin e nevojshëm të punëtorëve sipas Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për dhënien e lejes për transmetim në radio dhe televizion. Në atë drejtim, një kohë të gjatë ka pasur komunikim ndërmjet Agjencisë dhe transmetuesit për të dorëzuar dokumentet me të dhënat e nevojshme, por siç e di Këshilli, kjo nuk ka ndodhur dhe për këtë arsye është nisur procedura për heqjen e lejes. Pas fillimit të procedurës, pak para festave të Vitit të Ri, TV Iris ka dorëzuar me e-mail dokumente të skanuara, por jo në formë të shkruar për tu parë nëse janë plotësuar kushtet e nevojshme nga Rregullorja. Më 4 janar 2023, dokumentet kanë mbërritur në Agjenci, janë shqyrtuar dhe janë në rregull. Ai bën me dije se 15 ditët nga fillimi i procedurës kanë skaduar më 3 janar të këtij viti, por duke pasur parasysh që situata është e favorshme dhe nuk do t'i mirret leja, nuk e ka problem që të ndërpritet procedura edhe pas skadimit të 15 ditëve pasi që transmetuesi i plotëson kushtet minimale kuadrovike. Për këtë arsye, i propozohet Këshillit që

të marrë Vendim për ndalimin e procedurës, i cili do t'i mundësojë transmetuesit të vazhdojë me veprimtarinë.

Z. Petrushevski tha se kjo është punë pozitive dhe natyrisht se do ta përkrahë propozimin për TV Iris.

Z. Ajdini tha se bëhet fjalë për një pikë pozitive në rendin e ditës dhe është mirë që transmetuesi arriti të plotësojë dokumentacionin, i cili konstaton se i plotëson kushtet minimale kuadrovice sipas Rregullores. Ai ka deklaruar se do të votojë për ndërprerjen e procedurës së nisur për heqjen e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për marrjen e ejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizioni IRIS SHPK Shtip, nr. 08- 902 datë 8.7.2015.

Sipas Raportit me shkrim për kontrollin e kryer të mbikëqyrjes administrative me nr.ark.03-28/1 datë 3.1.2023, është konstatuar se SHTR Televizion IRIS SHPK Shtip i plotëson kushtet minimale kuadrovice (të personelit) të përcaktuara në Rregulloren për teknikat minimale, hapësinor, financiar dhe kuadrovice për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojnë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski e shpjegoi Propozimin për fillimin e konsultimit publik për ndryshim dhe plotësim në "Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion" pas Kërkesës së paraqitur nga SHGM. Ai ka shpjeguar se para se SHGM-ja zyrtarisht ta dorëzonte kërkesën, së bashku me kryetarin e shoqatës, drejtorin e SHGM-së dhe dy anëtarë të SHGM-së, është mbajtur një takim në Agjenci ku janë diskutuar dhe njoftuar për iniciativën dhe dëshirën e tyre për ndryshimin e kësaj Rregulloreje. Thelbi i ndryshimit është që transmetuesit kombëtarë të punësojnë, përkatësisht të angazhojnë gazetarë jashtë qytetit të Shkupit, përkatësisht të angazhojnë një numër të caktuar kameramanësh dhe korrespondentësh që do të raportojnë për tema të niveli rajonal dhe lokal. Në këtë moment, sipas SHGM, vetëm një pjesë e vogël e transmetuesve kombëtarë kanë kameramanë dhe korrespondentë jashtë Shkupit. Për këtë qëllim, nëse do të ketë ndryshim në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovice për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion, propozohet që të ketë një takim me transmetuesit kombëtarë, SHGM dhe Këshillin në mënyrë që të perceptohen pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, dhe më pas, në varësi të atij takimi dhe diskutimi do të fillojë ose jo ndryshimi (modifikimi) i Rregullores.

Z. Fidanoski tha se do të mbështes hapjen e një konsultimi publik për këtë çështje, për këtë propozim apo kërkesë të SHGM-së për të parë nëse kushtimisht ekziston një disponim kritik në komunitetin mediatik, veçanërisht tek transmetuesit kombëtar për ta pranuar dhe zbatuar atë kështu që në këtë mënyrë do të hapet një spektër i gjerë në kuadr lokal të peizazhit mediatik. Siç tha ai, është po aq e rëndësishme që vetë transmetuesit kombëtarë të inkorporojnë në programet e tyre një përqindje të caktuar të emisioneve, çështjeve dhe temave që lidhen drejtpërdrejt me çështjet lokale apo rajonale, sepse në fund një pjesë e mirë e audiencës që është shikues i këtyre televizioneve vijnë nga jashtë Shkupit. Ai absolutisht

beson se nëse temat trajtohen në mënyrë adekuate në programet e këtyre transmetuesve, do të ngjallin interesim të madh. Ai u pajtua me idenë se tema të tilla mund të hapen ose mbulohen nga njerëz që jetojnë në ato mjedise dhe që mund t'i shtjellojnë ato më detajisht.

Z. Ajdini mendon se si ide nga ana e ZSHGM-së është e mirë dhe se të gjithë meritojnë të informohen nga gazetarë korrespondentë të karakterit vendor. Siç thuhet në Kërkesën e tyre, duhet të merret një vendim për fillimin e një konsultimi publik në lidhje me ndryshimet dhe shtesat e propozuara të Rregullores që do të zgjasë 30 ditë. Ai e përkrah këtë, por do të donte të dinte edhe qëndrimin e transmetuesve për shembull, cili është interesi i TV Alsat që të ketë korrespondent në Strumicë. Por është mirë të dëgjohen pikëpamjet e tyre dhe nëse do të fillojë një konsultim publik do të shihet më vonë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Konkluzion për fillimin e një konsultimi publik në lidhje me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të "Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion" (Tekst i pastruar) nr. 01-3747/1 datë 6.10.2022, pas Kërkesës së dorëzuar nga Shoqata (Asociacioni) e Gazetarëve të Maqedonisë (Nr.yni.ark.03.23/1 datë 3.1.2023).

Konsultimet publike do të zgjasin 30 ditë, gjatë së cilës televizionet shtetërore si dhe të gjitha palët e tjera të interesuara, do të ftohen të shprehin mendimin e tyre në lidhje me propozimin e Shoqatës ( Asociacionit) të Gazetarëve të Maqedonisë para se të procedohet me ndryshimin e " Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion" (Teksti i pastruar) nr.01-3747/1 datë 6.10.2022.

#### **Pika 4**

Trajçevski e shpjegoi Propozimin - vendimin për refuzimin e Kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit tokësor digjital, të paraqitur nga ana e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJ Shtip. Ai shpjegoi se SHTR 24 Vesti kishte paraqitur Kërkesë në ASHMA për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit tokësor dixhital. Agjencia në pajtim me LSHMAAV, përmes furnizimit publik, angazhoi kompaninë MARKET VISION Shkup për të përgatitur një Studim i cili do të përcaktojë arsyetimin për shpalljen e konkursit publik. Sipas konkluzioneve të Studimit është rekomanduar që të mos shpallet konkursi, sepse nuk ka kushte për pjesëmarrës të ri në treg. Këtë vendim TV 24 Vesti e ankimoi në Gjykatën Administrative, e cila e anuloi vendimin dhe e ktheu në Këshill për rivendim. Sipas LSHMAAV, për shpalljen e konkursit duhet të ketë një Studim që do të përcaktojë nevojën e publikimit të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit dixhital tokësor. Megjithatë, studimi që është bërë nga MARKET VISION është një kompani, sipas Ligjit për Prokurim Studimi që është bërë nga ana e MARKET VINSON është kompani në pajtim me Ligjin për furnizime publike e kualifikuar për të bërë një studim të tillë. Në materialet është bashkëngjitur shtojcë se kjo Agjenci marketingu është anëtare e shoqatës ndërkombëtare, shoqatës profesionale ESOMAR/ ESOMAR , për të cilën ka dëshminë/certifikatën e duhur, si dhe në vitin 2021 një pjesë serioze e të ardhurave që kjo kompani, kishte mbi 7 milionë denarë të hyra nga hulumtimet e tilla të tregut dhe shqyrtim të opinionit publik. Duke pasur parasysh faktin se në maj të vitit të kaluar kishte një Studim i cili tregonte se nuk mund të shpallet tender(konkurs) dhe meqenëse kushtet nuk kanë ndryshuar, sugjerohet që Këshilli të marrë

sërisht të njëjtin vendim që Kërkesa për shpallje të konkursit publik të jetë refuzuar dhe gjithashtu pas dorëzimit të llogarive përfundimtare të transmetuesve dhe përgatitjes së Analizës së tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, pra 30 ditë pas publikimit të kësaj Analize, dhe kjo është diku nga mesi i këtij viti, korrik ose gusht, Këshilli sipas detyrës zyrtare të nisë procedurën për dhënien e kontratës për furnizimin publik për përgatitjen e një Studimi për të përcaktuar arsyetimin e shpalljes së konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit dixhital tokësor.

Z. Petrushevski tha se në materialet janë dy pika kryesore. E para është ajo që tha drejtori, që Këshilli duhet t'i përmbahet vendimit origjinal të datës 18 dhjetor 2020, se refuzon Kërkesën për shpalljen e konkursit publik dhe propozimi i dytë është duke pasur parasysh kushtet e ndryshuara dhe të shihet se si është në këtë vit për të përgatitur një Studim të ri brenda 30 ditëve nga publikimi i Analizës së Tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale 2022 që pritet të ndodhë në korrik të këtij viti. Me këto dy vendime, Këshilli përmbush plotësisht Vendimin e gjykatës dhe kërkesën e palës së interesuar. Ai beson se ky është një vendim i drejtë dhe korrekt. Me këtë ai deklaroi se do ta mbështesë propozimin në tërësi.

Z. Trajçev tha se i ka shqyrtuar materialet dhe vendimin e propozuar. Prej tyre shihet se ASHMA-ja ka bërë një analizë të hollësishme të rasteve dhe është duke i dhënë përgjigjet përkatëse aktgjykimit. Ai e shqyrtoi aktgjykimin dhe u befasua nga ndërhyrja e gjykatës në metodologjinë e përgatitjes së Studimit, për arsye se gjykata dhe Këshilli nuk janë ekspert të mjaftueshëm, prandaj për atë punë angazhohen ekspertë. Në veçanti, ai tha se pjesa që lidhet me veprimtarinë mbizotëruese, nga aktgjykimi i gjykatës, ku veprimtaria mbizotëruese përcaktohet nga ajo që personi juridik bën maksimumin dhe përcaktohet automatikisht pas dorëzimit të llogarisë përfundimtare, por kjo nuk do të thotë se ai përjashton kryerjen e veprimtarive të tjera në pajtim (përputhje) me marrëveshjen e shoqërisë ose në pajtim me atë që është regjistruar si e drejtë dhe i jepet të kryejë veprimtari të caktuara. Në këtë pjesë ai beson se kompania që ka prodhuar Studimin, edhe pse nuk ka veprimtari të tillë mbizotërues, ka të drejtë të kryejë veprimtari të tillë sepse për shkak se një klauzolë e tillë dhe përveç kësaj është e mbështetur me dokumente të tjera. Megjithatë, duke qenë se është pro monitorimit institucional të udhëzimeve të gjykatës, ai mendon se duhet të ndiqen udhëzimet dhe të bëhet studim i ri, megjithëse edhe pas atij studimi ndoshta do të ishte i njëjti rezultat sepse tashmë dy herë është konfirmuar. Megjithatë, ai tha se proceduralisht, institucionalisht do të përmbahet nga vendimi i propozuar nga drejtori sepse mendon se duhet bërë studim i ri. Me këtë ai tha se ka dhënë argumentet e tij në këtë prezantim.

Z. Petrushevski sqaroi se në materialet tashmë është propozuar që të vazhdohet me përgatitjen e studimi të ri, me që Agjencia do ta fillojë atë procedurë nga mesi i këtij viti . Kjo pyetje ka marrë përgjigje, por sigurisht që respekton qëndrimin e z. Trajçev. Meqenëse nuk pati diskutime, propozimi u hodh në votim për marrjen e Vendimit për refuzimin e Kërkesës për shpalljen e konkursit publik për dhënien e ejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit dixhital tokësor nga ana e TV 24 Vesti nga Shtipi së bashku me të gjitha konkluzionet që janë theksuar në vetë vendimin, nënkupton votim për studimin e ri diku në korrik.

Për këtë propozim votuan tre anëtarë të Këshillit, z. Petrushevski, z. Ajdini dhe znj. Mashoviq dhe tre abstenime nga z. Fidanoski, z. Trajçev dhe z. Jançeski.

Z. Petrushevski pas votimit tha se ky nuk është vendim i mirë për Këshillin sepse në fakt nuk marrin asnjë vendim dhe kjo hap hapësirë të mëtejshme për komplikime. Vendimi nuk u mor me këtë votim dhe lind pyetja nëse ata kanë të drejtë të paraqesin një propozim të ri për të vendim të ri. Në këtë drejtim ai kërkoi nga anëtarët e Këshillit që të paraqesin propozim të ri sepse ende nuk kanë marrë ndonjë vendim.

Z. Trajçev tha se e tha mendimin e tij në prezantim. Ka vendim gjykate ku ka udhëzime që në kuadër të kësaj procedure duhet bërë një studim i ri. Ai theksoi se është pro ndjekjes së udhëzimeve të gjykatës dhe përgatitjes së një studimi të ri.

Z. Petrushevski i tha z. Trajçev se në propozimin e Këshillit thuhet se do të përgatitet një studim i ri pas publikimit të Analizës së tregut për vitin 2022. Përmbahet në propozim dhe përkon me mendimin e tij.

Z. Trajçev tha se ka dallim, gjegjësisht në këtë procedurë ku ka kërkesë konkrete, ka procedurë administrative, ku gjykata ka dhënë udhëzime, zotimi i tij është që në kuadër të kësaj procedure të përgatitet Studim në kuadër të kësaj procedure, të mirren qartë të gjitha parametrat që janë në pjesën e udhëzimeve të gjykatës dhe të përgatit një Studim, ky është propozimi i tij.

Z. Petrushevski sqaroi se në propozimin të refuzohet vendimi në faqen 53 të materialit, në fund të këtij vendimi shkruhet: “Në pajtim me nenin 70 paragrafi (1) të LSHMAAV, me qëllim të përcaktimit të arsytimit për shpallje konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit dixhital tokësor në vitin 2023, Këshilli i Agjencisë, në afat 30 (tridhjetë) ditëve nga publikimi i Analizës së tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, sipas detyrës zyrtare do të nisë procedurë për dhënien e kontratës për furnizim publik për përgatitjen e Studimi për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit dixhital tokësor”. Kjo do të thotë se përgatitja e Studimi të ri përfshihet në vetë propozimin.

Z. Trajçevski shpjegoi se me të dhënat për llogaritë përfundimtare për vitin 2021, tashmë është përgatitur Studim dhe ai Studim është pranuar në muajin maj 2022 dhe rezultatet e këtij Studimi janë përsëri identike. Tani nëse bëhet Studim në këtë moment, nuk do të ketë të dhëna të ndryshme nga ato që janë përfshirë në atë Studim që është bërë vitin e kaluar. Vetëm pas dorëzimit të llogarive përfundimtare për vitin 2022 atëherë do të mund të vlerësohet nëse ka pasur ndonjë ndryshim. Fjala vjen, është bërë studim me llogaritë përfundimtare të vitit 2021 dhe vitin e kaluar në maj ishte pikë në rendin e ditës të seancës së Këshillit. Kështu që shpallja aktuale e konkursit është e panevojshme sepse në këtë moment nuk ka të dhëna të reja që disponojmë për të bërë Studim të ndryshëm nga ai i vitit të kaluar.

Z. Petrushevski tha se tani është i interesuar se çfarë do të vijojë ligjërish. Këshilli tani nuk ka marrë vendim pasi votimi kaloi me 3 vota “pro” dhe 3 abstenime.

Z. Fidanoski kërkoi nëse është e mundur të marin disa minuta pauzë, në mënyrë që jashtë pjesës zyrtare të bëhen konsultime, për të parë se si qëndrojnë me afatet në kohë dhe të ngjashme.

Z. Petrushevski dha 10 minuta pushim.

Pas përfundimit të pauzës, z. Petrushevski përkujtoi se kishte votim për Propozim-vendimin me 3 vota "për" dhe 3 abstenime. Me kërkesën e tij kolegët që abstenuan kanë propozim se si mund të zgjidhet kjo, pra propozim që do të ishte i pranueshëm për të gjithë.

Z. Trajçev shpjegoi se prezantimi i tij ishte me qëllim që Këshilli të veprojë sipas udhëzimeve të gjykatës, ku gjykata thotë se duhet të përgatitet Studimi i ri. Të dhënat që disponohen për momentin për përgatitjen e Studimit janë ato të vitit paraprak me të cilat tashmë është përgatitur Studimi dhe është konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për shpalljen e konkursit. Duke qenë se është proceduralisht e pamundur të pritët dhe Këshilli duhet të marrë vendim, ai propozoi që në vetë vendim të shtohet se pas publikimit të të dhënave për vitin 2022 menjëherë të shpallet studimi. Me këtë në një farë mënyre ndjekim udhëzimet e gjykatës, mirret vendim dhe pas njoftimit të të dhënave do të shpallet furnizim publik për përgatitjen e Studimit, siç ka treguar gjykata, dhe në këtë mënyrë do të plotësohet dhe kërkesa e gjykatës.

Z. Fidanovski shtoi se pas 30 ditësh nga marrja e këtyre të dhënave, Këshilli duhet të hap procedurë për shpalljen e njoftimit për përgatitjen e Studimi të ri.

Z. Petrushevski tha se në bazë të asaj që u tha deri më tani, do të mundohet të formulohet ndryshim (amendament) të vendimit, që do të thotë se në vetë vendimin futet neni i ri "3" dhe neni 3 i mëparshëm bëhet neni 4. Neni i ri 3 thotë: "Sipas nenit 70 paragrafi (1) të LSHMAAV, me qëllim për të përcaktuar arsyetimin e shpalljes së konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror përmes multipleksit dixhital tokësor për vitin 2023, Këshilli i Agjencia, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga publikimi i Analizës së tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022, sipas detyrës zyrtare do të fillojë procedurën për dhënien e kontratës për furnizim publik për përgatitjen e studimit për të përcaktuar arsyetimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi dixhital tokësor". Ai sqaroi se vendimin e modifikuar të marrë pas diskutimeve të z. Trajçev, z. Fidanovski dhe sipas propozimit të tij do ta vë në votim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi vendim me të cilin refuzoi Kërkesën me shkrim të palës së interesuar, Shoqërisë tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJP Shtip me nr.ark.03-67/1 datë 5.2.2020. (Nr.ynë.ark. 08-55 datë 11.2.2020 ) me plotësim me nr.ark. 03-958/2 datë 21.9.2020 (Nr.ynë.ark. 08-94, datë 22.9.2020), për shpallje konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv të shërbimi programor me format të përgjithshëm kryesisht informativ ose me format të përgjithshëm me të tre funksionet mediatike (informativ, edukativ dhe argëtues), në nivel shtetëror, nëpërmjet multipleksi dixhital tokësor, për arsye se me Studimin për përcaktimin e arsyetimit të shpalljes së konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi dixhital tokësor (ark. nr. 03-4391/4, datë 11.12.2020) , u konstatua se nuk ka arsyetim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për shërbime programore televizive me format të përgjithshëm kryesisht informativ dhe format të përgjithshëm në të cilin llojet e përfaqësuara të programeve realizojnë të tre funksionet mediatike (informativ, edukativ dhe argëtues), në nivel shtetëror , nëpërmjet multipleksi dixhital tokësor.

Në bazë të nenit 70 paragrafi (1) të LSHMAAV, me qëllim për të përcaktuar arsyetimin për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror

përmes multipleksit dixhital tokësor për vitin 2023, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditë nga publikimi i Analizës të tregut të Shërbimit Mediatik Audio dhe Audiovizual për vitin 2022, sipas detyrës zyrtare do të nisë procedurë për dhënien e kontratës për furnizim publik për përgatitjen e studimit për përcaktimin e arsyesimit të shpalljes konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksi dixhital tokësor.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli të publikojnë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pikat 5 dhe 6**

Z. Petrushevski propozoi pikat 5 dhe 6, pasi bëhet fjalë për të njëjtin medium, TV Spektra, dhe shkelje të ndryshme të ligjit të shpjegohen në hyrje të përbashkët dhe votimi të jetë i ndarë për secilën pikë.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilia Janevska, i ka shpjeguar propozimet për shqiptim të masës vërejtje publike të Shoqërisë Tregtare me veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna e Labunishtës SHPKNJP për shkelje të nenit 50 paragrafit (3) të LSHMAAV dhe neneve 16 dhe 17 të Rregullore për mbrojtjen e personave të mitur dhe për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se shkeljet janë konstatuar me mbikëqyrje të rregullt të kryer në muajin nëntor. Por duke qenë se raportet kanë udhëtuar për një kohë të gjatë së bashku me kërkesën për deklaram nga transmetuesi, shqyrtimi i raporteve është transferuar në këtë vit. Shkelja e parë ka të bëjë me mbrojtjen e personave të mitur. Është konstatuar se në ditën e kryerjes së mbikëqyrjes transmetuesi ka transmetuar dy filma artistikë me klasifikim të gabuar, pra në vend të emërimit si program i kategorisë 4 programe 16+ e cila nuk rekomandohen për fëmijët nën 16 vjeç dhe mund të transmetohen në periudhën prej orës 22 deri në orën 06, transmetuesi i kishte shënuar si programe të kategorisë 2 që nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 8 vjeç. Në të njëjtën kohë një nga filmat u transmetua në një kohë të papërshtatshme të ditënatës. Shkelja e dytë janë rregullat për transmetimin e veprave audiovizuale maqedonase. Në vend të 30% në baza ditore, në ditën kur është bërë mbikëqyrja janë transmetuar 4,84% të veprave audiovizuale maqedonase. Në të njëjtën kohë kërkesa ligjore që gjysma e 30% e veprave audiovizuale maqedonase të transmetohen në periudhën nga ora 7 deri në orën 19 nuk është përbushur. Prej aty, për të dyja shkeljet i propozohet transmetuesit që t'i shqiptohet masë vërejtje publike me afat respektimi prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimeve dhe më pas të kryehet mbikëqyrje kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi ka vepruar.

### **Votimi për pikën 5**

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4439/1 datë 29.11.2022 dhe njëzëri ka konstatuar që Shoqërisë Tregtare për veprimtarinë Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna e Labunishtës SHPKNJP t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe neneve 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e personave të mitur sepse më 4 nëntor 2022, filmi artistik " Dobar den da se umre mashki" është transmetuar me sinjalizim të gabuar (8+) dhe në kohë të papërshtatshme të ditës dhe natës , dhe filmi artistik " Devojkata od vozot " u transmetua me sinjalizim paralajmërues të gabuar (8+).



Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masës nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, është urdhëruar në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit për shqiptim të masës vërejtje publike të harmonizoj veprimtarinë e tij me LSHMAAV dhe Rregulloren për mbrojtjen e personave të mitur .

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli, duhet ta publikoj aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore nr.10-4432/1 datë 29.11.2022 dhe njëzëri ka konstatuar se ShoqërisëTregtare për veprimtari Radiodifuzive SPEKTRA, Komuna e Labunishtës SHPKNJP t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV sepse më 4 nëntor 2022, nuk ka transmetuar të paktën 30% të programeve të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase në periudhën nga ora 7,00 deri në orën 19,00.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrje të masës nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, është urdhëruar brenda 30 ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale .

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojë Aktvendim e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### **Pikat 7 dhe 8**

Z. Petrushevski propozoi që Pikat 7 dhe 8, pasi që janë për media të njëjta, RADIO UNIVERSITARE STUDENT FM 92.9, dhe shkelje të ndryshme të Ligjit të shpjegohen në hyrje të përbashkët dhe votimi të jetë i ndarë për secilën pikë.

